



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "NNP Vëllezërit Sahiti" të datës 26.03.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Menaxhimi i mbeturinave" me nr. të prokurimit 616-24-11988-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "NNP Vëllezërit Sahiti" të datës 26.03.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Menaxhimi i mbeturinave".
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHET** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "NNP Vëllezërit Sahiti" (tutje "parashtruesi") me datë 26.03.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Menaxhimi i mbeturinave" me nr. të prokurimit 616-24-11988-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi nr. 1 -

Tek kapaciteti teknik dhe profesional ashtu sic e sqaruma me lart po e theksojm edhe tani se AK – ZPP pas vendimit te nxjerr nga OSHP - PSH nr. 2024/1260 te dates 03.03.2025 I ka larguar nga kapaciteti teknik dhe profesional sic ka qene: "4. LLOTOT 1, 2 dhe 3 –të gjithë kamionët e mbeturinave të jenë të pajisur me një sistem të avancuar identifikimi (idenSystem) të integruar në pjesën e pasme të kamionit. Ky sistem duhet të bëjë leximin e qipave RFID të cilët janë të vendosur në kontejnerët e mbeturinave. I gjithë ky sistem duhet të jetë i lidhur me internet në mënyrë që të dhënat e zbrazjeve të përcillen në kohë reale në Softwarin C-Trace të cilin e posedon Komuna e Prishtinës, ose ndonjë software të ngjajshëm që e kryen funksionin e njëjt"

Ndersa AK – ZPP pas vendimi te PSH nr. 2024/1260 ku e aprovon ankesne e OE dhe e detyron AK te korigjoj DT, me date 17.03.2025 e korigjon DT duke e ngarkuar ne platformen elektronike e-prokurim duke e larguar nga kapaciteti teknik dhe profesional neni 9.1 & 9.2 te FDT-se por perseri kete KERKESE E VENDOS NE ANEKSIN 1 – SPECIFIKIMI TEKNIK po citojm:

Pretendimi nr. 2 -

Tek **Aneksi 7. PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM DHE AFATI PËR KRYERJEN E PUNIMEVE** autoriteti kontraktues ka përcaktuar për LLOT-OT 1, 2, 3 dhe 6 – kamionët e mbeturinave të jenë me peshë bartëse 12000-16000 kg

Kërkesa e lartcekur është kërkesë diskriminuese për OE të interesuar për ofertim në këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht favorizuese për OE të caktuar, për faktin se kjo kërkesa tek Aneksi 7 është kufizuese dhe diskriminues, për faktin se pesha bartëse e kamioneve nga 12000-16000kg është shumë specifike dhe paraqet kufizim për OE andaj kerkojm nga AK te largoj /korigjoj kete kërkesa duke ulurr minimum e kërkuar deri ne 9000 apo /ose 9900 kg (qe i bie pesha bartëse per kamion: 10000KG) , andaj kerkojm te analizoj tregun dhe natyren eketyre shërbimeve AK se bashku me NJK dhe personat pergjegjes dhe te merr per baze kerkesen tone duke rritur konkurrence duke na lajuar te ofetojm edhe me vlera minimale te peshes bartes te kampioneve edhe me vlera: 10000 Kg, ne menyre qe te mos jete ne shkelje te nenit 7. 51 dhe 69 te LPP-se.

Pretendimi nr. 3 -

	zbatimin e nenit 99.2 te LPP-se Shuma e Sigurimit të Tenderit është: Për LOT 1 70,200 Euro Për LOT 2 39,000 Euro Për LOT 3 35,100 Euro Për LOT 4 15,600 Euro Për LOT 5 15,600 Euro Për LOT 6 39,000 Euro për periudhë valide prej 60 ditësh: 150 ditësh.
--	---

Keto kërkesa janë në shkelje të neni 28 dhe 30 te Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik – verisoni i konsoliduar, për faktin se vlefshmeria e tenderit për vlera të mëdha shtet makizim 90 dite ndersa sigurimi i tenderit kerkohet vetem 30 dite me teper se sa vlefshmeria e tenderit, andaj keto kërkesa paraqesin barrë për OE kur dihet se vlera e ketyre sigurimeve është shumë e lartë prandaj keto kërkesa janë shpenzime të panevoshme për OE dhe përben edhe kufizim i konkurrencës duke qene nje barre krejt e pa nevojshem dhe e pa arsyeshme dhe kunderligjore me kete kërkesa te jashte ligjshme.....sipas rregullores dhe dispozitave te LPP-se.

Pretendimi nr. 4 -

Po ashtu, AK duhet të mer për bazë dhe të analizoj për faktin se pajisjet e mëposhtme të specifikuar në **Aneksin 7 te FDT-së** janë të panevojshme – kundërt thënë në vet-vete, andaj kerkojm nga AK – ZPP te korigjojne dhe plotesojn ne pajtim te plote me vendimin e OSHP – PSH nr. 2024/1260 duke përcaktuar paisje konkretisht kamion me pesha bartes më liberale, me të arsyeshme, të qarta dhe proporcionale me natyrën e aktivitetit të prokurimit si dhe të rrisin konkurrencën dhe jo duke diskriminuar duke ju pamundesuar disa OE që të tenderojnë këto AP. Pran me fjale tjerat e ule vleren minimale për pesha bartes të kampioneve:

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 1, duke u referuar në vendimin e OSHP 2024/1260 është gjetur se AK duhet të rishikoj kërkesën e DT si vijon "Lotet 1, 2 dhe 3 -të gjithë kamionët e mbeturinave të jenë të pajisur me një sistem të avancuar identifikimi (idenSystem) të integruar në pjesën e pasme të kamionit. Ky sistem duhet të bëjë leximin e qipave RFID të cilët janë të vendosur në kontejnerët e mbeturinave". Prandaj pretendimi nr. 1 është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 2 dhe 4, peshat e pajisjeve janë hartuar me kujdes nga personat kompetent të njësishë kërkuuese në përputhje të plotë me nenin 7 lidhur me nenin 27 dhe 28 të LPP. Në anën tjetër parashtuesi nuk ka prezantuar asnjë provë apo argument për të mbështetur pretendimin ankimor. Për më tepër specifikat e pajisjeve kanë tolerancë të mjaftueshme për të evituar çdo mundësi për diskriminim. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 3, validiteti i ofertës dhe sigurimi i tenderit janë në përputhje të plotë me nenin 28 dhe 30 të RRPP. Kjo për arsye se për tender me vlerë të madhe minimumi i validitetit të ofertës është 90 ndërsa në rastin konkret validiteti është kërkuar vetëm 120 ditë. Sigurimi i tenderit gjithmonë është 30 ditë më shumë. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtuesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si pjesërisht e bazuar.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 01.04.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.